



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Ekonominë dhe Financat

PROCESVERBAL

Tiranë, më 23.01.2020, ora 11:40

Drejton mbledhjen

Milva Ekonomi – kryetare e Komisionit

Rendi i ditës:

1. Miratimi i procesverbaleve të muajit dhjetor 2019 për datat 2, 3, 10, 11, 12, 13, 16, 17.
2. Shqyrtimi i projektligjit “Për shkëmbimin automatik të informacionit të llogarive financiare”
3. Shqyrtimi i aktit normativ “Për disa shtesa në ligjin nr.8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar”.

Marrin pjesë:

Milva Ekonomi, Arben Elezi, Evis Kushi, Antoneta Dhima, Reme Lala, Ervin Bushati, Blerina Gjylameti, , Xhavit Bushaj, Roland Xhelilaj, Senida Mesi, Vullnet Sinaj, Edlira Hyseni, Artur Roshi, Krenar Ryçi, Ylli Shehu.

Mungojnë:

Anastas Angjeli, Korab Lita, Eljo Hysko,

Të ftuar:

Elton Haxhi - Zëvendësministër i Financave dhe Ekonomisë

Mimoza Dhëmbi - Drejtoreshë e Përgjithshme në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë

Nikolla Lera - Drejtor i Përgjithshëm në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë

Xhoana Agolli – Drejtoreshë në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë

Pandeli Majko - Ministër i Shtetit për Diasporën

Milva Ekonomi- Hapim mbledhjen e dytë me këtë rend dite: miratimi i procesverbaleve të muajit dhjetor të vitit 2019, për datat 2, 3, 10, 11, 12, 13 dhe 16 dhjetor.

Shqyrtimi i projektligjit “Për shkëmbimin automatik të informacionit të llogarive financiare” dhe shqyrtimin e aktit normativ “Për disa ndryshime në ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 “ Për tatimin mbi të ardhura”.

A jeni dakord me procesverbalet?

Ndërkohë kemi një ndryshim rendor të rendi i ditës, do të fillojmë me shqyrtimin e aktit normativ “Për disa shtesa në ligjin nr. 8438” për të cilin kemi relatore zonjën Evis Kushi.

Të ftuar kemi zotin Pandeli Majko, ministër Shteti për Diasporën dhe zotin Elton Haxhi, zëvendësministër i Ekonomisë dhe Financave, Mimoza Dhembli, Drejtoreshë e Përgjithshme në Ministrinë e Ekonomisë dhe Financave, Nikolla Lera, Drejtor i Përgjithshëm në Ministrinë e Ekonomisë dhe Financave, Xhoana Agolli, Drejtoreshë në Ministrinë e Ekonomisë dhe Financave.

Fillojmë me relatoren.

Evis Kushi - Akti normativ nr. 10, datë 18.12.2019 “Për disa shtesa në ligjin nr.8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar” është paraqitur për miratim nga Këshilli i Ministrave. Akti është propozuar nga Ministri i Shtetit për Diasporën.

Projektligji është propozuar nga Këshilli i Ministrave në përputhje me nenin 101 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

Akti normativ nr. 10 datë 18.12.2019 “Për disa shtesa në ligjin nr.8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar”, aktualisht është publikuar në Fletoren Zyrtare nr. 173 datë 18.12.2019 dhe Kuvendi është brenda afateve Kushtetuese për ta shqyrtuar atë.

Qëllimi i këtij akti normativ është shtimi në listën e përjashtimeve nga tatimi mbi të ardhurat, edhe të të ardhurave nga pensionet dhe shpërblimet e tjera të ngjashme të shtetasve të huaj me origjinë shqiptare apo të atyre nga vendet e Bashkimit Evropian, me leje qëndrimi në Republikën e Shqipërisë, si dhe të shtetasve të huaj që kanë marrë shtetësinë shqiptare dhe janë rezidentë në Republikën e Shqipërisë dhe që i përfitojnë këto të ardhura sipas legjislacionit të vendit ku përfitojnë pensionin apo shpërblimet e tjera të ngjashme.

Për ta bërë të zbatueshëm këtë përjashtim, akti normativ ka përcaktuar edhe kushtet që duhet të plotësojë një shtetas për ta përfituar atë. Këto kushte konsistojnë në:

Këta shtetas nuk duhet të kenë qenë ndonjëherë të dënuar në shtetin e vet, në Republikën e Shqipërisë ,ose në ndonjë shtet tjetër për vepra penale, për të cilat ligji parashikon dënime me jo më pak se 3 vjet heqje lirie, si dhe të kenë marrë përgjigje pozitive nga struktura përgjegjëse administrative për përjashtim nga tatimi mbi të ardhurat personale të përfitimit të pensionit.

Unë e vlerësoj dhe është një iniciativë shumë e rëndësishme, sepse shtohen lehtësitë për shtetasit e huaj dhe shtetasit e huaj me origjinë shqiptare për të zgjedhur Shqipërinë si vendbanimin e tyre pas daljes në pension; sjell impakt pozitiv në rritjen e lëvizjes së shtetasve të huaj në drejtim të Shqipërisë, forcimin e lidhjeve të shtetasve shqiptarë që jetojnë jashtë vendit të origjinës, rritjen e kërkesës për shërbime në nivel vendor, zhvillim të ofertës për shërbime, kujdes e turizëm.

Unë shpreh plotësisht dakordësinë time për këtë akt normativ, por shqetësimi që kisha pak më parë dhe arsyeja që kërkoja informacione shtesë në lidhje me këtë akt normativ kanë të bëjnë me anën procedurale. Këto propozime ne na vijnë me akt normativ, ndërkohë që Kushtetuta parashikon që akti normativ mund të zgjidhet si metodë nga qeveria në rastin e nevojës dhe urgjencës, siç e diskutuam pak më parë për aktin tjetër normativ. Unë nuk isha e qartë në lidhje me emergjencën, nevoja dihet, sepse ka shumë shtetas që përfitojnë nga ky akt normativ, por nuk isha e qartë në lidhje me emergjencën pse ky ndryshim ligjor duhet të vijë me akt normativ. Për këtë arsye kërkoja nga shërbimet juridike të Kuvendit që të na sjellin një informacion më të detajuar pse ky akt normativ nuk kalon nëpërmjet Komisionit të Ligjeve, i cili është më i specializuar për të na dhënë neve një opinion ekspertësh në lidhje me anën procedurale. Meqenëse ministri i Shtetit për Diasporën u shpreh i gatshëm që të japë këto lloj argumentesh që ne nuk i kemi në relacion dhe për këtë arsye nuk isha e qartë, atëherë unë jam dakord që ta vazhdojmë mbledhjen dhe zoti Majko të na japë këto informacione.

Pra, unë këto shqetësime që kam po i ngre pyetje. Pyetja e parë: Pse është zgjedhur akti normativ dhe jo procedura normale e propozimit të një ndryshimi ligjor?

Pyetja e dytë lidhet me Ministrinë e Financave, sepse normalisht ligji për tatimin mbi të ardhurat administrohet nga Ministria e Financave dhe pse nuk vjen propozim prej tyre? A jeni konsultuar ju me Ministrinë e Financave? A keni një opinion zyrtar në lidhje me këtë akt normativ?

Në aktin normativ parashikohet përjashtimi nga tatimi mbi të ardhurat për të ardhurat nga pensionet dhe shpërblimet e tjera të ngjashme. Pra kështu është specifikuar. Doja një informacion pak më të gjerë në lidhje me shpërblime të tjera të ngjashme, sepse duket shumë e gjerë. Falënderoj për këtë iniciativë shumë të dobishme ministrin e Diasporës!

Milva Ekonomi – Vendosëm një rregull që çdo pyetje e bërë të marrë përgjigje nga ju. Nuk e di nëse pas sqarimeve të relatores mund të ketë pyetje që linden edhe si pasojë e mbledhjes së mëparshme, prandaj, zoti Majko, mund të na shpjegoni më qartë, pastaj zoti Harxhi.

Pandeli Majko- Një nga arsyet për të cilat ne jemi të vetëdijshëm për informacionet e plota që duhet të ketë parlamenti na bën të qartë lidhur me arsyetimin pse jemi këtu dhe jemi të gatshëm edhe në rast se komisioni merr vendimin për ta shtyrë. Unë jam i gatshëm të jap informacion të plotë.

Duke pasur mirëkuptimin e koleges relatores mendoj se arsyetimi i emergjencës ka qenë lidhur me dy arsye: vendimi i aktit normativ është marrë më datën 18.12.2019, që është edhe Dita Ndërkombëtare e Emigracionit dhe Shqipëria ka të njëjtën datë të emigracionit si edhe Kombet e Bashkuara. Shqipëria në këtë periudhë ka qenë në një emergjencë të fatkeqësisë natyrore. Ne donim që aktin normativ ta kishim në kushte të emergjencës administrative, donim ta kalonim para mbarimit të sesionit të kaluar parlamentar, por në atë moment Shqipëria u gjend para fatkeqësisë natyrore, për të cilin reagimi i diasporës ka qenë si asnjëherë më parë për t'iu gjendur zonave të dëmtuara nga tërmeti. Ne jemi duke ndjekur një politikë agresive për ta kthyer Shqipërinë në një vend të dashur jo vetëm në kuptimin e nostalgjisë, por edhe në kuptimin ekonomik të fjalës. Në këtë këndvështrim krahas kësaj politike që kemi marrë për çështjen e marrëveshjes në fushën e pensioneve me të gjitha shtetet ku kemi komunitet shqiptarë prezentë, kemi edhe propozime që kanë të bëjnë me ligjin e shtetësisë dhe të investimeve, por për rastin përkatës të ndryshimit të ligjit 8438, kemi marrë modelin portugez. Portugalia është një vend me emigracion goxha të zhvilluar dhe ata për të pasur një politikë agresive kanë krijuar një model të natyrave të tilla. Ne jemi përpjekur të krijojmë një model, i cili të nxisë shtetasit e huaj dhe me origjinë shqiptare ta shikojnë vendin e tyre si një vend të dashur dhe tek i cili të gjejnë nostalgjinë, por edhe interesin ekonomik.

Në nenin e parë të projektaktit normativ përkufizohen të ardhurat që do të përjashtohen.

Unë do të cilësoja nenin e dytë ku ne nuk duam të ishim thjesht përcaktues në parim të këtij përjashtimi, por kemi vendosur detaje administrative edhe për dhënien e përgjigjes, edhe për ankimimin në sistemin gjyqësor nëse kjo nuk fitohet, me qëllim që të mos kemi shmangie ose shkelje të të drejtave të shtetasve që do ta kërkojnë këtë.

Gjithashtu, dëshiroj të them se këtë akt e kemi zhvilluar në bashkëpunim të ngushtë me Ministrinë e Financave dhe të Drejtësisë. Ky akt nuk mund të kalonte dhe të bëhej vendim në Këshillin e Ministrave pa marrë dakordësinë e dy institucioneve.

Është një politikë, siç e thashë, agresive, e cila kërkon t'i lidhë më shumë komunitetet shqiptare jashtë vendit. Unë sigurisht besoj se kur të diskutohet ligji për shtetësinë, marrjen e rezidencës dhe shtetësisë, parlamenti duhet të krijojë një koncept më liberal sa i përket marrëdhënieve me komunitetet shqiptare. E kemi një pasuri të jashtëzakonshme jashtë vendit që quhet diasporë, me të cilën duhet të forcojmë lidhjet, por edhe t'i krijojmë akses që të mos ndihet në distancë. Mendojmë se ky akt normativ, lirimi nga tatimi mbi të ardhurat, që po bëjmë sot, sidomos me pensionet është vetëm një hap i parë. Më e rëndësishme është çështja e pensioneve. Aktualisht edhe për informacionin tuaj qeveria ka vendosur një koordinator shtetëror, i cili është duke e ndjekur hap pas hapi dhe në Komitetin Shtetëror të Diasporës raporton çdo tre muaj në lidhje me ecurinë e këtyre marrëveshjeve. Janë pazëla të ndara, është një strategji, e cila po pret ligjin e investimeve, ligjin e shtetësisë dhe sigurisht sot kemi sjellë edhe këtë akt normativ. Kam mirëkuptim të plotë lidhur me pyetjen që u shtrua dhe informacionin që donte relatorja dhe komisioni lidhur me emergjencën dhe kërkoj mirëkuptim lidhur me arsyetimin e emergjencës administrative.

Pra, ne jemi ende në emergjencën e fatkeqësisë natyrore dhe donim që ta kalonim ligjin para sesionit. Kërkoj mirëkuptimin tuaj.

Milva Ekonomi- Po.

Elton Haxhi – Pa dyshim që akti, siç e theksoi edhe ministri, është konsultuar me Ministrinë e Financave, e cila ka qenë në mbështetje të çdo iniciative që kontribuon në komunitetin e diasporës. Duke qenë se akti nuk ka asnjë impakt fiskal negativ, përkundrazi pritet që të ketë impakt pozitiv, mendojmë ta mbështesim ministrin në këtë iniciativë dhe në zbatueshmërinë e tij.

Milva Ekonomi- Po, Edlira.

Edlira Hyseni - Së pari, unë përshëndes iniciativën, pavarësisht se vjen në formën e një akti normativ për të cilën edhe unë ju kisha pyetur paraprakisht për të kuptuar instrumentin e përdorur, urgjencën, por është e kuptueshme lidhur me shpjegimin që ju dhatë për situatën e krijuar në fund të vitit 2019.

Unë mendoj se është një ndryshim pozitiv dhe i mirëpritur qoftë për diasporën, qoftë për shtetasit e huaj që zgjedhin Shqipërinë. Tashmë ka kohë që shtetas të huaj zgjedhin Shqipërinë për të kaluar jetën në moshën e pensionit, ose për shqiptarët që kanë marrë shtetësinë huaj, por që shpresojmë të jenë të motivuar edhe më shumë për t'u rikthyer në vendin e tyre për të kaluar pleqërinë.

Në fakt, për të gjitha lehtësirat që i bëhet kësaj kategorie unë shpresoj të mos jetë një kompensim që të ikë rinia dhe të vijë pleqëria. Shpresojmë që Shqipëria të jetë një vend që popullohet nga rinia, së pari, pastaj pa dyshim edhe mosha e tretë, se janë prindërit tanë.

Mua, pasi lexova aktin normativ, ku bëhet fjalë për një përjashtim nga tatimi mbi të ardhurat më lind një pyetje, ose do të doja të asqaronit për qytetarët dhe për të gjithë ne se për cilin lloj tatimi flasim konkretisht. Ju thoni që nuk ka impakt financiar.

Pra, konkretisht në këtë moment po përjashtojmë nga tatimi mbi të ardhurat një kategori personash kur, në fakt, deri sot nuk e përfitojnë, pra ne aktualisht nuk kemi një të ardhur nga kjo kategori. Pra, nuk e kemi dhe vazhdojmë të mos e kemi, por që ta kenë të qartë të gjithë përjashtohet tatimi mbi pensionet, pastaj format e tjera të shpërblimit mund t'i detajojmë. Kolegia e kishte pyetje se cilat do të ishin rastet e tjera, për çfarë shpërblimesh flasim.

Në këtë akt normativ ne miratojmë përjashtimin nga tatimi i të ardhurave nga pensionet për shtetasit shqiptarë që kanë marrë pasaportat e huaja, ose shtetas të huaj me kushtin që të jenë rezidentë në Shqipëri. Shqipëria nuk i taton pensionet sipas ligjeve tona, vendet e tjera po. Me këtë akt normativ, cilat pensione po përjashtojmë? Të marrim një shembull, shtetasit italianë përfitojnë pension në vendin e tyre, por zgjedhin të vijnë e të jetojnë në Shqipëri, atëherë me këtë akt normativ ne iu themi atyre që Shqipëria është një vend më i mirë qoftë edhe i leverdishëm ekonomikisht, sepse nuk do të paguajnë tatimin mbi pensionin e tyre, tatimin që paguajnë në vendin e tyre apo ndonjë tatim eventual që paguajnë te ne. Ne thamë që nuk paguajnë te ne. Por a kemi ne mundësi të bëjmë vendet e tjera të përjashtojnë nga tatimi kategorinë e tyre të popullatës që sot taten? Pra, ne nuk kemi as të mira as të këqija nga kjo punë, por, në fakt, ka një impakt negativ mbi financat e vendeve të tjera. A janë ata dakord?

Pra, ky akt normativ a nuk do të ishte më shumë, së pari, një marrëveshje, një miratim i marrëveshjeve dypalëshe me vendet e tjera? A janë dakord vendet e tjera që ne t'iu marrim këtë kategori njerëzish dhe të mos paguajnë atje?

Angazhimi ynë është shumë pozitiv, por a jemi të sigurt që e kemi fuqinë ta bëjmë këtë dhe si ua garantojmë këtyre njerëzve që po erdhën të jetojnë këtu, nuk do të paguajnë taksa dhe tatime? Pra, cilin tatim ne po përjashtojmë, tatimin këtu apo në vendin e tyre? Pra, nëse do të motivojmë pensionistët të jetojnë në Shqipëri, sikurse gjejmë mekanizma të tjerë që të motivojmë emigrantët ose njerëzit që jetojnë jashtë diaspora ose të gjithë familjarët tanë të rikthehen në Shqipëri, unë shpresoj të gjejmë metoda ose instrumente të tjera që të rikthehet edhe forca e punës, të rikthehet edhe rinia dhe jo vetëm mosha e tretë, por gjithsesi ky është një hap i parë, për t'iu thënë këtyre njerëzve që të kthehen e të jetojnë në Shqipëri dhe të japin kontribut minimal në ekonominë tonë, nga cili tatim apo nga cila barrë fiskale po i lirojmë? Na e thoni thjesht dhe qartë që ta kuptojmë!

Elton Haxhi- Ne kemi vënë si kusht që duhet të jenë rezidentë shqiptarë. Kjo do të thotë që në legjislacionin tonë, nëse je rezident shqiptar, pra me rezidencën fiskale në Shqipëri tatohesh për të ardhurat globale. Kjo do të thotë se pensionet që përfiton në një shtet tjetër janë subjekt i tatimit edhe në Shqipëri. Pra, të gjithë këta shtetas që përfitojnë pensione jo nga sistemi ynë i pensioneve, sepse ato janë vërtet të përjashtuara, pensionet që përfitojnë në vendet e tjera nuk janë të përjashtuara, këtu te ne dhe, duke u bërë rezident këtu në Shqipëri, i binte që pa këtë ndryshim ligjor ne do të kërkonim tatim edhe në Shqipëri ose zbatimin e marrëveshjeve dypalëshe. Tani për të mos hyrë te marrëveshjet dypalëshe, ne po i përjashtojmë nga tatimi nga detyrimet tatimore për këto të ardhura që janë pensione. Për t'iu rikthyer edhe pyetjes së zonjës Kushi, ndjesë që nuk iu përgjigja më parë, bëhet fjalë për pensione të skemës së pensionit të detyrueshëm ose të skemës vullnetare, pra të ardhurat e tjera, bëhet fjalë për pensionet vullnetare. Ne po japim këtë përjashtim pastaj rregullimin me shtetin tjetër, nëse do të tatohen atje, apo jo këtë e rregullon marrëveshja dypalëshe.

Edlira Hyseni - Është mirë që ta sqarojmë. Flitet për një tatim që duhet të paguajnë në Shqipëri dhe që deri sot përderisa themi impakti është zero, pra efekti financiar është zero, do të thotë që deri në këtë moment ne nuk i kemi tatuar këto të ardhura, sepse nuk po jap shpjegimin, por do të doja të dija nëse kemi një informacion se sa shtetas të huaj kanë sot rezidencën në Shqipëri, aktualisht dhe sa do të përfitojnë nga ky akt normativ. Pra, sa është numri i shtetasve të

huaj në moshë pensioni që përfitojnë pension dhe që kanë rezidencën në Shqipëri? Sa njerëz do të gëzohen sot dhe sa do të presin të gëzohen më pas?

Pandeli Majko- Të jem i singertë, nuk kemi ecur shumë me këtë metodikë, sepse edhe Instituti i Statistikave ka dy vjet që prodhon një dokument zyrtar, raportin vjetor për emigracionin dhe diasporën, por jemi të bindur për atë që do të vijë dhe ajo që do të vijë është vetëm pozitive. Pra, unë nuk e thashë kot atë që ta kthejmë vendin në një vend të dashur edhe ekonomikisht. Marrja e rezidencës bashkëlidhet edhe me ligjin e shtetësisë, që është dorëzuar në parlament dhe, kur të jetë në Komisionin e Ekonomisë, unë do të përpiqem të jem, sepse duhet të ndjekim një politikë liberale në dhënien e rezidencës ose në procedurat e shtetësisë me komunitetet shqiptare jashtë vendit. Kanë një dashuri të madhe për të marrë atë dokumentin e pasaportës shqiptare ose për të marrë rezidencën në Shqipëri. Ndërkaq paralelisht ne kemi krijuar edhe mekanizma të tjerë, për shembull, në muajin nëntor kemi krijuar dhomën e biznesit të diasporës, e cila është bërë me akt të veçantë të Këshillit të Ministrave, pjesë e këshillit të investimeve, por bëhet pjesë e Unionit të Biznesit dhe e projektligjit të investimeve, që është depozituar në parlament. Pra, janë një varg masash, prandaj thashë që ky akt normativ është një pazëll i asaj që ne jemi duke ngritur si strategji me vendet jashtë

Milva Ekonomi – Kolegë, a ka pyetje të tjera? A keni nevojë për sqarime të tjera për këtë akt normativ? Ok

Ta hedhim në votim? Kush është dakord me aktin normativ “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar, të ligjit nr.8438, datë 28.12.1998? Nuk shoh kundër. Nuk shoh abstenim. Unanimitet. Faleminderit!

Zoti Majko, doja t’ju kërkoja edhe mirëkuptimin, sepse e vini re që ky komision është gjithmonë shumë serioz dhe i merr çështjet shumë seriozisht për t’i bërë të diskutueshme në prezencën tuaj dhe të medias.

Përfaqësuesit e Ministrisë së Financave do të vazhdojnë të jenë këtu në komision, ndërsa ju, zoti Majko, ju falënderoj për mirëkuptimin.

Sekretar
Anastas Angjeli

Përgjegjësjë e Sektorit të Redaktorëve
Euzheni Pengili

Sekretar i komisionit
Elvi Prifti



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Ekonominë dhe Financat

PROCESVERBAL

Tiranë më, 23.01.2010, ora 10:00

Drejton mbledhjen:

Milva Ekonomi – kryetare e Komisionit

Rendi i ditës:

Projektligji “Për shkëmbimin automatik të informacionit të llogarive financiare”

Marrin pjesë:

Milva Ekonomi, Arben Elezi, Evis Kushi, Antoneta Dhima, Reme Lala,
Ervin Bushati, Blerina Gjylameti, , Xhavit Bushaj, Roland Xhelilaj, Senida Mesi, Vullnet
Sinaj, Edlira Hyseni, Artur Roshi, Krenar Ryçi, Ylli Shehu.

Mungojnë:

Anastas Angjeli, Korab Lita, Eljo Hysko,

Të ftuar:

Elton Haxhi - Zëvendësministër i Financave dhe Ekonomisë

Mimoza Dhëmbi - Drejtoreshë e Përgjithshme në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë

Nikolla Lera - Drejtor i Përgjithshëm në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë

Xhoana Agolli – Drejtoreshë në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë

Pandeli Majko - Ministër i Shtetit për Diasporën

Milva Ekonomi – Do të vazhdojmë me projektligjin që ka të bëjë me shkëmbimin automatik të informacionit të llogarive financiare.

Për këtë projektligj kemi caktuar si relatore zonjën Antoneta Dhima. Ministria e Financave përfaqësohet nga zoti Haxhi për të bërë diskutimet e nevojshme.

Zonja Dhima, keni fjalën.

Antoneta Dhima – Faleminderit!

Së pari, ju uroj suksese në drejtimin e Komisionit të Ekonomisë dhe Financës.

Projektligji “Për shkëmbimin automatik të informacionit të llogarive financiare” është propozuar nga Këshilli i Ministrave dhe diskutohet sot nga Komisioni për Ekonominë dhe Financat në cilësinë e komisionit përgjegjës në përputhje me procedurat e parashikuara në nenet 32-39 të Rregullores së Kuvendit.

Qëllimi i projektligjit është realizimi i shkëmbimit automatik të informacionit të llogarive financiare midis administratave tatimore të vendit tonë dhe të vendeve të tjera për tatimpaguesit (individë ose njësi ekonomike) jorezidentë. Nëpërmjet këtij shkëmbimi të informacionit synohet identifikimi i të gjithë tatimpaguesve jorezidentë për efekt të shlyerjes së detyrimeve tatimore, duke ndikuar në shmangien e evazionit fiskal dhe të mashtrimit tatimor.

Ky shkëmbim i informacionit është bërë i domosdoshëm në kushtet kur ekonomia po bëhet gjithnjë e më e globalizuar dhe është zgjeruar lëvizja ndërkombëtare e personave, kapitalit, mallrave e shërbimeve. Ky fenomen, krahas efekteve pozitive, ka rritur mundësinë për shmangien e pagimit të detyrimeve tatimore dhe të evazionit fiskal. Shumë individë apo njësi ekonomike kryejnë dhe menaxhojnë investime, nëpërmjet institucioneve financiare, jashtë vendeve të tyre të rezidencës. Një pjesë e tyre nuk evidentohen, duke shmangur pagesën e detyrimeve tatimore. Disa individë apo njësi ekonomike i mbajnë paratë “offshore”, duke mos u tatuar. Evazoni tatimor përmes “offshore” është një problem serioz në të gjitha vendet. Për të shmangur këtë fenomen, lindi nevoja e bashkëpunimit midis administratave tatimore të vendeve të ndryshme për shkëmbimin automatik të informacionit.

Projektligji synon:

- Krijimin e një mjeti efikas për realizimin e shkëmbimit automatik të informacionit;

- Garantimin e mbledhjes së informacionit nga institucionet financiare raportuese;
- Përcaktimin e termave dhe kushteve të përgjithshme për grumbullimin, përpunimin, përditësimin, bashkëveprimin, përqasjen, ruajtjen, përdorimin dhe arkivimin e informacionit në kuadër të këtij ligji, si dhe detyrat dhe kompetencat e autoritetit kompetent për të siguruar zbatimin efektiv të ligjit.

Në vitin 2013, vendet e G20 miratuan Standardin e Përbashkët të Raportimit për Shkëmbimin Automatik të Informacionit. Ky standard u kërkon qeverive që të marrin informacion të hollësishëm nga institucionet e tyre financiare për llogaritë financiare të jorezidentëve. Këtë informacion çdo shtet duhet ta shkëmbejë automatikisht, çdo vit, me shtetet e tjera. Informacioni që duhet të shkëmbehet, sipas standardit, ka objekt llogaritë financiare, duke përfshirë bilancet, interesat, dividendët, të drejtat dhe të ardhurat nga shitja e aseteve financiare. Ky informacion duhet të mblidhet dhe raportohet në qeveri (kuptohet administrata tatimore) nga institucionet financiare.

Nevoja për këtë projektligj lindi për të zbatuar dispozitat e “Konventës për ndihmën administrative të ndërsjellë në çështjet tatimore”, të ratifikuar nga Kuvendi me ligjin nr.146/2013. Shqipëria e ka ratifikuar këtë Konventë me ligjin nr.146, datë 6.5.2013. Konventa është nënshkruar nga shtetet anëtare të Këshillit të Europës dhe të Organizatës për Bashkëpunim Ekonomik e Zhvillim (OECD). Ajo parashikon ndihmën dhe bashkëpunimin e ndërsjellë të vendeve nënshkruese për çështjet tatimore. Konventa zbatohet për tatimin mbi të ardhurat, fitimet, fitimet kapitale ose pasuritë neto, kontributet e detyrueshme të sigurimeve shoqërore etj. Konventa parashikon shkëmbimin e informacionit në lidhje me tatimet. Ky shkëmbim i informacionit mund të realizohet me kërkesë të shtetit kërkuar, në mënyrë automatike çdo vit, spontan apo duke kryer ekzaminime të njëkohshme tatimore. Një nga këto forma është shkëmbimi automatik i informacionit nga dy ose më shumë palë, i parashikuar në nenin 6 të Konventës. Informacioni shkëmbehet midis autoriteteve tatimore të vendeve të ndryshme. Konventa parashikon edhe ruajtjen e konfidencialitetit të të dhënave dhe mbrojtjen e të dhënave personale.

Shqipëria është pjesë e këtij Forumi që prej vitit 2012. Ky Forum mbështetet nga G20. Forumi ka rekomanduar që Shqipëria duhet të hartojë aktet ligjore primare dhe sekondare për zbatimin e shkëmbimit automatik të informacionit ndërmjet vendeve që kanë nënshkruar marrëveshjen shumëpalëshe.

Në zbatim të nenit 6 të Konventës për Ndihmën Administrative të Ndërsjellë në Çështjet Tatimore, Shqipëria ka nënshkruar Marrëveshjen Shumëpalëshe të Autoritetit Kompetent për Shkëmbimin Automatik të Informacionit të Llogarisë Financiare. Kjo marrëveshje është miratuar me VKM nr.178, datë 9.3.2016. Palët në marrëveshje janë të njëjta me palët e parashikuara në Konventë. Marrëveshja, ashtu si dhe Konventa, parashikon që shkëmbimi i informacionit mund të kryhet mbi baza dypalëshe nga autoritetet kompetente.

Informacioni, i cili jepet për çdo llogari të raportueshme, përmban të dhëna identifikuese për mbajtësin e llogarisë, i cili mund të jetë individ apo njësi ekonomike, gjendjen e llogarisë ose vlerën. Në rastin e një llogarie kujdestarie, informacioni përmban të dhëna mbi interesat, dividendët, të ardhurat nga aktivet e mbajtura në llogari apo të shitura. Në rastin e një llogarie depozite, informacioni përmban të dhëna mbi interesat. Informacioni duhet të shkëmbehet në mënyrë automatike, brenda 9 muajve pas përfundimit të vitit kalendarik për të cilin bëhet raportimi. Autoritetet kompetente bien dakord edhe për metodat e transmetimit të të dhënave, me synim maksimizimin e standardizimit dhe minimizimin e shpenzimeve.

Marrëveshja parashikon që Shqipëria të zbatojë shkëmbimin automatik të informacionit deri në fund të vitit 2018, për të pasur kohë për krijimin e bazës ligjore dhe të infrastrukturës së nevojshme për zbatimin e saj, por që faktikisht nuk është realizuar.

Palët nënshkruese të marrëveshjes kanë rënë dakord që të miratojnë e zbatojnë një standard të vetëm e të ri global për shkëmbimin automatik të informacionit mbi tatimpaguesit, si dhe zbatimin e njëjtë dhe efektiv të këtij standardi. Për zbatimin e këtij detyrimi, nevojitet një sistem që të shkëmbejë të dhëna konfidenciale ndërmjet administratave tatimore të vendit rezident dhe vendit ku realizohen të ardhurat, fitimet etj. Një gamë e gjerë e informacionit do të shkëmbehet mbi llogaritë *offshore*, përfshirë bilancet e llogarive dhe të pronësisë. Në rastet e konstatimit të evazionit fiskal, qeveritë duhet të marrin masa për eliminimin e tij.

Informacioni mbahet nga institucionet financiare raportuese, të cilat janë:

- Institucionet e kujdestarisë;
- Institucionet depozituese;
- Subjektet e investimit;
- Shoqëritë e sigurimeve, të cilat janë të specifikuara.

Informacioni duhet të jetë i vlefshëm, i aksesueshëm dhe konfidencial.

Këto institucione mbledhin, përpunojnë dhe më pas raportojnë informacionin në administratën tatimore.

Sistemi i shkëmbimit automatik të informacionit do të shërbejë për transmetimin sistematik dhe periodik të të dhënave të tatimpaguesit nga ana e vendit burim i të ardhurave, në vendin e qëndrimit. Ky sistem përfshin:

- Shkëmbimin automatik të informacionit të llogarive financiare;
- Institucionet financiare që duhet të raportojnë;
- Llojet e ndryshme të llogarive dhe tatimpaguesve;
- Procedurat e përbashkëta që duhet të zbatojnë institucionet financiare.

Autoriteti kompetent për zbatimin e shkëmbimit automatik të informacionit në vendin tonë është Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve. Kjo Drejtori do të mbledhë të dhënat nga institucionet financiare raportuese. Ajo do ta shkëmbejë informacionin me vendet që janë pjesë e marrëveshjes. Pas miratimit të ligjit, Këshilli i Ministrave do të nxjerrë rregulla për:

- Procedurat për vigjilencën e duhur;
- Raportimin e informacionit nga institucionet financiare tek Drejtoria e Tatimeve;
- Përkufizimet e nevojshme;
- Masat për të siguruar zbatimin efektiv të këtij ligji.

Zbatimi i detyrimeve të këtij ligji kërkon implementimin e një sistemi të ri teknologjik, i cili ka një kosto prej 45 milionë lekësh për vënien në zbatim të sistemit; dhe 15 milionë lekë/vit për mirëmbajtjen e sistemit teknologjik.

Si përfundim, miratimi i projektligjit “Për shkëmbimin automatik të informacionit të llogarive financiare” është mjaft i rëndësishëm, pasi është një detyrim që rrjedh nga konventa ndërkombëtare, e ratifikuar nga Kuvendi që në vitin 2013. Ky shkëmbim i informacionit do të realizohet sipas standardeve ndërkombëtare, madje, miratimi i këtij projektligji është i vonuar, pasi sipas marrëveshjes ndërkombëtare, që ka nënshkruar vendi ynë në vitin 2016, parashikohej që Shqipëria ta realizonte shkëmbimin automatik të informacionit brenda vitit 2018. Miratimi i këtij projektligji do të luajë një rol të rëndësishëm në reduktimin e evazionit fiskal, mashtrimin tatimor dhe do të ndikojë pozitivisht në vendosjen e konkurrencës së ndershme të treg.

Të nderuar kolegë, në kushtet kur ne jemi duke shqyrtuar këtë projektligj në përputhje me Kushtetutën dhe Rregulloren, unë ju ftoj të gjithëve që ta miratojmë në mënyrë unanime këtë projektligj.

Në fakt, zonja kryetare, unë kam edhe dy pyetje, por në fillim po dëgjoj mendimin e përfaqësuesve të Ministrisë së Financave

Faleminderit!

Milva Ekonomi – Unë mendoj që para se të kalojmë në diskutimet dhe pyetjet për këtë projektligj, Ministria e Financave të na japë mendimin e vet për këtë projektligj, kohën si jeni me ecurinë e programit dhe pastaj ne do të kalojmë në pyetje.

Elton Haxhi – Unë nuk kam gjë për të shtuar për shpjegimin e projektaktit, pasi ishte shterues nga ana e deputetes, por do të doja të theksoja rëndësinë e projektaktit.

Ky projektakt ka qenë i parashikuar për t'u miratuar në vitin 2019, por për shkak të emergjencës nuk arriti të kalonte gjithë hallkat e miratimit në komisionet parlamentare. Gjej rastin të vlerësoj edhe vendosjen e këtij projektakti në krye të axhendës për vitin 2020. Ne kemi pasur një komunikim të vazhdueshëm me forumin global dhe me OECD-në në lidhje me afatet e zbatimit të këtij akti dhe kemi gjetur gjithë dakordësinë e tyre për ta pasur këtë akt në fillim në vitin 2018 dhe pastaj për shkak të risisë që sjell ky projektakt, duke qenë se edhe vendet e tjera të zhvilluara e kanë miratuar gjatë periudhës 2017-2018, kemi gjetur dakordësinë që plani i implementimit të këtij shkëmbimi automatik të shtyhej për vitin 2020.

Gjithashtu, më lejoni të informoj që sipas komunikimit të fundit që kemi me Forumin Global, kemi marrë edhe një shtyrje për vitin 2021 duke qenë se projektakti nuk kaloi brenda vitit 2019. Gjithsesi, miratimi i këtij projektakti në këtë moment në fillim të vitit, na lejon që të planifikojmë implementimin e tij brenda afateve, pra brenda angazhimit të mëparshëm që kishim në vitin 2020 për të filluar shkëmbimin e informacionit.

Shqipëria është vendi i 103-të që e aplikon këtë shkëmbim informacioni. Janë tashmë 102 vende që e kanë realizuar këtë shkëmbim informacioni, por në rajon Shqipëria është vendi i parë që e zbaton, pra në Ballkanin Perëndimor Shqipëria është në pararojë të bashkëpunimit tatimor me shtetet anëtare të kësaj konvente dhe për shkëmbim informacioni.

Jemi këtu për t'iu përgjigjur pyetjeve që mund të vijnë nga deputetët.

Faleminderit!

Milva Ekonomi – Ndërkohë, Edlira ka një pyetje, Neta ka disa pyetje.

Edlira Hyseni - Problemi i Edlirës është që nuk ka asnjëherë një pyetje, ka gjithmonë më shumë se një pyetje.

Ky është një ligj shumë i rëndësishëm, pavarësisht se në opinionin publik debatohet pak, nuk është se ka ndonjë konsultë të gjerë ose përhapje të informacionit lidhur me këtë ndryshim që ky ligj sjell.

Është një ligj i rëndësishëm në luftën kundër evazionit dhe qarkullimit të lekëve të papastras, prandaj është një hap i mirë për Shqipërinë. Nuk e dija që Shqipëria është vendi i parë në rajon dhe kjo më duket shumë pozitive dhe do të doja të dija pse Shqipëria është flamurtare për këtë, sepse ka një dilemë lidhur me mundësinë e qarkullimit në Shqipëri të kësaj problematike, pra, ekziston informacioni që në Shqipëri ka shtetas të huaj, individë ose subjekte që kanë llogari të depozituara dhe nuk janë të deklaruar në vendet e tyre të origjinës, apo ka shumë shqiptarë që i kanë jashtë? Pse Shqipëria është pioniere e kësaj nisme në rajon? Në fakt, kjo është një nismë për t'u komplimentuar e për t'u vlerësuar.

Unë, duke lexuar ligjin dhe relacionin, i cili ishte shterues, sepse relacioni që shoqëron ligjin është një kopje e përsëritur e vetë ligjit, vura re që nuk jepen shumë informacione të tjera dhe do të ishte me interes që në relacionin që shpjegon ligjin të shpjegoheshin më qartë ato që ligji përsërit disa herë dhe që janë nocionet bazë, autoriteti kompetent. E para, subjektet e ligjit janë institucionet financiare ose përgjithësisht bankat që janë në Republikën e Shqipërisë, të gjitha bankat, bankat shqiptare, bankat e huaja, çdo bankë në Republikën e Shqipërisë detyrohet të zbatojë këtë ligj. Pra, autoriteti kompetent janë tatimet shqiptare, nëse jam e saktë.

Personi i raportueshëm dhe llogari të raportueshme. Duke lexuar përkufizimin, në relacion nuk shpjegohet qartë se kush janë personat e raportueshëm dhe cilat janë llogaritë e raportueshme. Duhet të lexojmë vetëm përkufizimin se çfarë duhet të thotë persona dhe llogari e raportueshme dhe aty duket sikur është lojë fjalësh. Nuk është shumë e qartë për t'u kuptuar thjesht e qartë. Cilët individë ose biznese, subjekte, qoftë individuale, qoftë tregtare, janë objekt i shqyrtimit të llogarive të tyre bankare për të cilat nga sot Shqipëria merr angazhim që do të raportojë juridiksionet e tjera, që mendojmë janë vendet e origjinës së këtyre subjekteve. Me juridiksionet e tjera, Shqipëria është e detyruar që për një shtetas italian të raportojë vetëm në vendin e tij të origjinës, pra vetëm në Itali, apo edhe në vende të tjera që janë pjesë e kësaj marrëveshjeje? Pra, ky shkëmbim automatik është gjithëpërfshirës apo i referohet vetëm vendit të origjinës së personit?

Në ligj nuk kuptohet mirë dhe do të doja që ju thjesht ta sqaronit cilat janë objektet ndaj të cilave do të bëhet ky verifikim.

Pyetja e dytë. Ligji hyn në fuqi nga tani e mbrapa. Ka ndonjë mekanizëm, ose fuqi prapavepruese, në kuptimin që bankat do të jenë të detyruara të japin informacione për llogari ose për shtete, pra për çdo gjë që është bërë përpara se të miratohet dhe të hyjë në fuqi ky ligj? Ta zëmë që janë shtetas që kanë pasur llogari, kanë bërë transaksione, por sot nuk i kanë. Kur janë pasiv, kanë detyrim raportimi, por kur kanë qenë deri në fund të vitit 2019 dhe në dijeni të këtij ndryshimi ligjor kanë marrë masa dhe nuk e kanë më, a kanë bankat detyrim të raportojnë edhe për ata? Pra, kemi fuqi prapavepruese?

A mund të themi që me këtë ligj nis detyrimi i Shqipërisë të raportojë në juridiksionet e tjera? E para, e thënë thjesht, ky ligj do të thotë që bankat do të raportojnë tek tatimet shqiptare dhe tatimet shqiptare do të raportojnë tek tatimet e huaja informacionin fillestar lidhur me gjendjen e llogarive. Pyetja do të ishte: raportojnë vetëm të dhënat e llogarive, tepicën në atë datë të raportimit, apo edhe transaksione të ndryshme në vlera apo mbase kanë një informacion sensibil që lind ndonjë dyshim për ato transaksione, pra detyrimi i raportimit është thjesht gjendja, teprica apo edhe transaksione të veçanta?

Me këtë ligj ne mund të themi që fillon detyrimi i Shqipërisë për të raportuar ndaj vendeve të tjera, apo edhe detyrimi i vendeve të tjera për të raportuar tek ne, apo tashmë vendet e tjera që kanë firmosur më përpara e kanë nisur këtë procedurë dhe ne kemi marrë informacione për shtetasit tanë, sepse ky ligj është detyrimi i shtetasve të huaj në Shqipëri për të shkëmbyer informacionin, por edhe i shtetasve shqiptarë që kanë llogari bankare në vende që aderojnë në këtë marrëveshje, pra është një shkëmbim informacioni që prek jo vetëm shtetasit e huaj, por edhe shtetasit shqiptarë. Dua të di nëse kjo deri më sot ka ndodhur për shtetasit shqiptarë, a kemi një informacion, apo vetëm me miratimin e këtij ligji do të fillojë detyrimi i vendeve të tjera për të raportuar lidhur me shtetasit shqiptarë?

Pyetja e fundit, këtë sistemin e ri teknologjik 45 milionë lekë dhe kostoja e mirëmbajtjes etj., kush do ta implementojë? Është autoriteti kompetent, që janë tatimet, apo është një program që instalohet për bankat? Për çfarë bëhet fjalë? 45 milionë lekë të rinj për një sistem të ri teknologjik është një kosto, do të ketë edhe një kosto tjetër vjetore mirëmbajtje. Logjika ma do që është për tatimet tona, përderisa e mbulon buxheti i shtetit, sepse nuk do të mbulonim një program për bankat, megjithatë do të ishte mirë të dinim se cili institucion e implementon këtë

program dhe për çfarë është i domosdoshëm ai, meqenëse edhe Komisioni i Ekonomisë ka edhe një përgjegjësi lidhur me angazhimet financiare.

Ju faleminderit!

Milva Ekonomi – Mendoj se duhet të jepni ju përgjigje, sepse kam përshtypjen se duke dhënë ju përgjigje, disa pyetje të zonjës Dhima mund të kalojnë.

Elton Haxhi – Faleminderit!

Atëherë: pse Shqipëria është vendi i parë?

Shqipëria ka qenë gjithmonë e listuar te vendet bashkëpunuese. Pra, ka qenë gjithmonë në grupin e vendeve që kanë pasur bashkëpunim të mirë tatimor me shtetet anëtare të Global Forum, të Forumit Global, apo edhe të formateve të tjera të bashkëpunimit tatimor, që ka OECD-ja. Si e tillë, e ka ratifikuar konventën e para, dhe ka marrë e para angazhimin për të implementuar këtë shkëmbim informacioni, gjë për të cilën duhet përgëzuar që në fillimet e marrjes së këtyre angazhimeve nga qeveria që në vitin 2013.

Vendet e tjera, fatkeqësisht, e kanë planifikuar, por nëse u referohemi listës, Mali i Zi e ka më 2023, ndërsa Bosnja, Maqedonia e Veriut dhe Serbia e kanë ende në fazë shqyrtimi. Pra, nuk kanë marrë angazhim për një datë, se kur do të fillojnë të transmetojnë.

Në lidhje me subjektet e ligjit, nëse u referohemi përkufizimeve, besoj se janë dhënë sqarime se kush janë subjekte të ligjit. Pra, personat e raportueshëm janë individë ose njësi ekonomike rezidentë të një shteti tjetër, të një juridiksioni tjetër, të cilët kanë llogari në sistemin bankar shqiptar. Subjektet raportuese janë sistemi bankar apo institucione të tjera, të cilat i ka përmendur ligji, që janë fonde investimi, institucione të tjera investuese apo edhe shoqëri të sigurimit, të cilat kanë polica sigurimi me përfitues jorezidentë, pra shtetas rezidentë të një juridiksioni tjetër. Të gjitha këto janë institucione raportuese.

Pra, angazhimi i individëve nuk është i nevojshëm. Kërkohet vetëm angazhimi i institucioneve raportuese. Institucionet raportuese kryejnë vigjilencën e duhur, sipas standardeve që përcakton konventa, të cilat do të detajohen me vendim të Këshillit të Ministrave. Pas kryerjes së vigjilencës së duhur, nëse identifikojnë se personi është jorezident dhe i plotëson kushtet e një personi të raportueshëm, do ta fusin në formatin e raportimit dhe do ta transmetojnë te administrata jonë tatimore.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po pra, pasi të kryejnë vigjilencën e duhur.

Vigjilenca e duhur nënkupton që banka duhet të identifikojë përfituesit e llogarive bankare, le të themi, dhe nëse ky përfitues i llogarisë bankare është rezident i një juridiksioni tjetër, do ta identifikojë si person të raportueshëm. Ato elementë që ky ligj përcakton se do të raportohen, do të futen në formatin e raportimit të standardizuar, sipas formatit që ka përcaktuar OECD-ja, që quhet standardi i përbashkët i raportimit, *common reporting standards*.

Nga momenti që banka raporton te administrata jonë tatimore, Administrata Tatimore ka si detyrim ta filtrojë informacionin, duke e ndarë sipas shteteve që janë subjekt i konventës, dhe ta transmetojë informacionin vetëm tek shteti i rezidencës, jo tek të gjithë. Pra, nëse një person i huaj është rezident italian, ai informacion i transmetohet autoritetit tatimor italian.

Data. Ligji përcakton se data e fillimit të raportimit është data 1 janar 2019. Pra, të gjitha llogaritë, të cilat janë ekzistente me 1 janar 2019, që janë të hapura në sistemin tonë bankar më 1 janar 2019, dhe të gjitha llogaritë që janë hapur pas kësaj date, janë objekt raportimi. Ato që janë mbyllur para datës 1 janar nuk janë objekt i raportimit.

Vitin tjetër do të vazhdojë gjithmonë duke raportuar të dhënat e vitit paraardhës. Afatet e raportimit janë përcaktuar jo më vonë se nëntë muaj pas mbylljes së vitit kalendarik. Pra 30 shtatori është afati i raportimit nga administrata tatimore, ndërsa nga sistemi bankar, afati i raportimit është maji.

Tani, për shkak se ky ligj u vonua, në qeveri është miratuar shtatorin e vitit 2019 dhe parashikonte se bankat duhej të raportonin në majin e 2020-ës. Duke qenë se ky projektligj mori kohë pak më shumë nga ç'ishte parashikuar, ne do t'i propozonim komisionit, që të bënte një shtyrje për bankat, jo për Administratën Tatimore, që t'u lihet kohë më e gjatë bankave për të kryer këtë vigjilencën e duhur. Do të propozonim një shtyrje me gjashtëdhjetë ditë. Pra afati për bankat, nga fundi i majit, si periudhë transitore të kalonte në fund të korrikut. Sa i përket administratës, të mbetet nëntëmujori, sepse është detyrim që e parashikon konventa. Nëse nuk arrin nëntëmujorin, i bie të raportosh vitin tjetër, jo këtë vit. Pra, nuk ka një periudhë tjetër raportimi, por duhet raportuar në fund të nëntëmujorit.

Pyetja tjetër ishte: për momentin, aktualisht, çfarë raportesh marrim ne? Për momentin, ne marrim raporte vetëm me kërkesë. Pra, jemi pjesë jo automatike. Ky është raport automatik, që pavarësisht nëse ti e kërkon apo s'e kërkon, ai të vjen dhe do të vijë. Pra, pasi ne të bëhemi pjesë e platformës, mbasi të kemi ndërtuar edhe sistemin e dhënies e të marrjes së informacionit, i bie që ky raportim të vijë në shtator.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ne do të marrim raport për të gjithë rezidentët shqiptarë, për llogaritë e tyre në shtetet që kanë firmosur dhe kanë filluar zbatimin e shkëmbimit të informacionit.

Programi i IT-së është një program që, siç e thashë, do të sigurojë marrjen e informacionit nga bankat dhe transmetimin e tij në një platformë që e ka OECD-ja, për shkëmbimin automatik të informacionit. Është një platformë e përbashkët...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Tek ne, tatimet.

Tatimet dhe akshi, nuk diskutohet. Akshi ka përgjegjësinë për ndërtimin e gjithë infrastrukturës qeveritare.

Do të implementohet nga tatimet dhe do të fillojë shkëmbimin e informacionit me platformën qendrore të shteteve anëtare të konventës. Bankat duhet të dizenojnë sistemin e tyre, në mënyrë që të marrë akses edhe ky sistemi që do të ndërtojmë ne te tatimet, për të shkëmbyer informacionin.

Për dijeninë tuaj, një sistem i ngjashëm ekziston vetëm për shtetasit amerikanë. Është Marrëveshja e FACT, e cila detyron bankat që mbajnë llogaritë e shtetasve amerikanë, që të transmetojnë një informacion të ngjashëm për qeverinë amerikane, në kuadër të shkëmbimit të informacionit tatimor.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jo, bankat e kanë marrëdhënien të pavarur nga tatimet, sepse është një marrëveshje specifike, që e ka departamenti i shtetit.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Tani do të raportojnë edhe në këtë platformë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jo, edhe interesat, sikur e kishin këtu.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Janë të gjithë. Pra, vigjilenca e duhur nënkupton që ti të identifikosh nëse është rezident i huaj apo jo.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Mirë, por është një procedurë, që duhet ta ushtrojë vigjilencën.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jo, jo, të gjithë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Vigjilenca nënkupton që ti të mos raportosh për dikë që s'duhet të raportosh, për dikë që s'është shtetas i huaj dhe nuk ka llogari...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Kur bën vigjilencën e duhur, gjykon, analizon të dhënat, nëse ky është rezident i vendit tonë apo i ndonjë shteti tjetër.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Milva Ekonomi – ... unë e di se ke edhe ca pyetje, ndaj s'po duron dot, kështu që a mund t'i...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po pra, ndërkohë e kuptuam.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ne duhet të marrim ca vendime...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Natyrisht, edhe ne. Është edhe për ne, edhe për ata. Ti shkëmben, në këtë rast. Duhet të bësh një bazë të ngjashme me ata të tjerët, që të shkëmbesh.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Është për ato çështje në lidhje me të cilat foli edhe Edlira, që...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Janë të gjitha vendet e Europës, ku kryesisht tregohet kujdes në luftën kundër pastrimit të parasë informale.

Antoneta, të lutem!

Antoneta Dhima – Zoti zëvendësministër, kam tri pyetje, pak a shumë edhe në vijim të pyetjeve që bëri kolegja Edlira:

Si paraqitet shkalla e ndërveprimit mes organeve tatimore në sistemin e informatikës, thesarit, Institutit të Sigurimeve Shoqërore dhe institucioneve të tjera, pasi nga Kontrolli i lartë i Shtetit janë evidentuar problematika në sistemin informatik.

E dyta: në buxhetin e vitit 2020, ju keni parashikuar kostot që vijnë nga zbatimi i këtij sistemi. A i keni llogaritur efektet financiare që do të ketë në vazhdimësi zbatimi i këtij sistemi?

Pyetja e fundit: pak a shumë e thatë edhe në fjalën tuaj, por cili është sistemi i teknologjisë së informacionit, që do të realizojë shkëmbimin e këtij informacioni midis vendeve, si dhe në çfarë faze ndodhet ndërtimi i këtij sistemi?

Faleminderit!

Elton Haxhi – Në lidhje me pyetjen e parë nuk jam shumë i qartë...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Milva Ekonomi – E ka akshi, në fakt.

Nëse mund ndihmoj sadopak në lidhje me pyetjen që bëri Neta, unë kam përshtypjen se do të ketë qenë një nga shënimet që ka lënë Kontrolli i Lartë i Shtetit në të kaluarën, për shkëmbimin automatik të informacioneve mes institucioneve. Ndërkohë, që nga viti i kaluar, kur është lënë ky informacion, e deri më sot, akshi ka bërë përparime.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Janë të lidhura edhe me këtë ligj, sepse është *e-Albania* që funksionon në një formë tjetër, është qeverisja që tregon se si funksionon...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Besoj se kjo pyetje mund të jetë një gjë pak shteruese, në kuptimin që ka të bëjë me evolucionin e akshit, nuk ka të bëjë direkt me ju. Është një shqetësim që ka qenë në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve.

Unë nuk e di si mund të jetë sot, por fakti që akshi ka evolucion, i bie që ky evolucion është përkthyer edhe te Drejtoria e Përgjithshme e tatimeve. Kështu e mendoj unë.

Elton Haxhi – Rezervoj të drejtën që t'i përgjigjem me shkrim zonjës deputete, sepse nuk kam ndonjë evidencë apo ndonjë indikator, që të mund ta bëj të ditur këtu në komision.

Në lidhje me pyetjen për sistemin, sistemi nuk ka filluar të ndërtohet ende, sepse pa u miratuar ligji nuk mund të fillonte implementimi. Pra, jemi në pritje të miratimit të ligjit. Më pas do të fillojmë menjëherë me fazën e implementimit. Edhe në hartimin e ligjit, Administrata Tatimore është asistuar nga ekspertë të OECD-së. Pra, ka pasur një asistencë të vazhdueshme nga ekspertë të OECD-së dhe nga Administrata Tatimore italiane, e cila në kuadër të bashkëpunimit me OECD-në, ka marrë përsipër ta asistojë Shqipërinë në implementimin e këtij shkëmbimi automatik të informacionit. Edhe në hartimin e termave të referencës apo të dizenjimit të sistemit, do të asistohemi nga të njëjtët ekspertë, nga ekspertë të OECD-së, në bashkëpunim me Administratën Tatimore italiane.

Në lidhje me përfitimet, unë mund t'ju jap informacion se sa kanë qenë përfitimet në vende të tjera. Mund t'jua vë në dispozicion me shkrim këtë informacion. Se sa kanë qenë përfitimet, nuk e kam me vete këtu, në komision, por kemi informacion që me fillimin e raportimit të shkëmbimit të informacionit, se sa kanë qenë përfitimet në shtete të tjera, pra sa kanë qenë të ardhurat tatimore, të cilat janë gjeneruar vetëm nga shkëmbimi i informacionit, dhe ju siguroj se është i rëndësishëm.

Milva Ekonomi – Pyetja e fundit për këtë, besoj, se duket sikur u plotësua qartësia.

Vazhdo, Edlira.

Edlira Hyseni – Një pyetje të thjeshtë kisha. Ky ligj është detyrues për bankat, për tatimet shqiptare dhe për ata të huaj që do të na raportojnë. A është arritur marrëveshja, dakordësia me të gjitha institucionet financiare në vend? Që do të jenë të detyruara me ligj, dakord, por a janë të predispozuar edhe ata në këtë bashkëpunim? A është marrë paraprakisht opinioni, konferma apo miratimi i tyre?

Me këtë ligj mund të themi se, nga shtatori 2020, Administrata Tatimore shqiptare do të ketë më shumë informacion. Deri tani e ka pasur me kërkesë, tani e tutje do ta ketë në mënyrë automatike mbi të gjithë shtetasit shqiptarë, që disponojnë llogari bankare në vendet të cilat aderojnë në këtë marrëveshje. Duhet të themi se informacioni funksionon vetëm brenda 103 vendeve.

Pra, shtytësit shqiptarë që kanë llogari bankare në vende të tjera, parajsa fiskale ose llogari *off shore*, jo domosdoshmërisht do të mund të marrim vesh akoma edhe për shumë kohë, se sa janë gjendjet e tyre bankare. Gjithsesi, më mirë se sa hiç informacion, do të kemi bërë një hap përpara. Mund të themi se në shtator do të kemi më shumë informacion për shtetasit shqiptarë, të cilët kanë llogari financiare jashtë vendit, gjithnjë për ato vende që e kanë firmosur këtë marrëveshje, por edhe vendet e tjera do të kenë më shumë informacion në lidhje me të huajt që janë në Shqipëri. Mendoj se kemi më shumë për të marrë, se sa për t'u dhënë. Pyetja do të ishte: ky ligj është goxha detyrues dhe impenjativ për të gjithë ata që lëvizin kapitale të larta. A mund të themi se ky detyrim i ri ligjor do t'i frikësojë më shumë shqiptarët apo të huajt? A mund të ndikojë në spostimin e kapitaleve drejt atyre vendeve të rajonit, të cilat nuk e kanë firmosur këtë ligj?

Ju faleminderit!

Elton Haxhi – Nëse i referoheni listës së vendeve që e kanë filluar shkëmbimin automatik të informacionit, janë pothuajse të gjitha vendet e Bashkimit Europian dhe vendet *off shore*. Pra janë: Bahamas, Barbados, Belize, Qipro, nëse mund ta konsiderojmë *off shore*, por edhe shumë vende të tjera si Marshall Islands apo vende të tjera, të cilat, në gjykimin tonë, bëjnë pjesë në grupin e vendeve *off shore*.

Tashmë, këto vende janë pjesë e transmetimit të informacionit, kështu që do të marrim informacione dhe prej tyre.

Sa i takon konsultimit me bankat, është bërë një konsultim i vazhdueshëm me bankat, në lidhje me pjesën e detyrimeve që ato kanë. Prandaj po e kërkojmë edhe këtë shtesën në afat, me qëllim që t'u lihen edhe dy muaj kohë më shumë për ushtrimin e vigjilencës së duhur. Për ta saktësuar, vigjilenca e duhur është për të gjithë, por tregohet kujdes më i madh ndaj atyre llogarive që kanë gjendje të madhe, dhe vigjilencë më të thjeshtuar ndaj atyre llogarive që kanë balancë më të ulët.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Detyrimi i raportimit është për të gjithë, por vigjilenca që duhet të bëjnë bankat me këto llogari, është e diferencuar, dhe diferencimi është në vlerën e 1 milion dollarëve. Ato që janë mbi një milion dollarë kanë tjetër vigjilencë, ndërsa ato që janë nën një milion dollarë kanë vigjilencë tjetër.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Rolant Xhelilaj – Mund të jetë e fundit, sepse na e mori Edlira gjithë kohën për pyetjet e fundit.

Kanë qenë tre opsione. Keni rënë dakord për opsionin e bërjes së një ligji të ri, që është normale, Çfarë lidhje ka ky ligj me ligjin ekzistues “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”. kanë mbivendosje ndaj njëri-tjetrit? Sa ndikojnë në përmirësimin e situatës, sa u takon tatimeve?

Elton Haxhi – Jo, nuk ka ndonjë lidhje me ligjin “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”. E ndihmon procedurën tatimore, pasi informacioni që mbledh edhe nga administratat e tjera tatimore mundësohet me këtë ligj, sepse ky ligj nuk i detyron administratat e tjera që të raportojnë, por është konventa ajo që i detyron. Pra, shkëmbimi i informacionit është pjesë e konventës. Ky ligj përcakton detyrimet për subjektet shqiptare, që janë bankat, për të raportuar.

Tatimet e merrnin këtë informacion me kërkesë, ndërsa tani do ta marrin në mënyrë automatike. Për efekt të procedurës tatimore, ka lidhje me bashkëpunimin tatimor, sepse këta janë shtetas rezidentë të një vendi tjetër, nuk paguajnë tatime në Shqipëri, por në një shtet tjetër.

Milva Ekonomi – Para se të kalojmë në proces votimi, doja t’jua sillja në vëmendje, se dy komisionet e tjera: Komisioni i Ligjeve dhe Komisioni i Integritetit, e kanë parë ligjin, e kanë diskutuar, e kanë miratuar dhe na i kanë sjellë me shkrim mendimet e tyre kështu që me këto dy depozitime që kemi nga komisionet përkatëse do të kalojmë edhe ne në procesin e votimit.

Kush është dakord për ta miratuar në parim projektligjin “Për shkëmbimin automatik të informacionit të llogarive financiare”?

Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Kalojmë në votimin nen për nen.

Kush është dakord me nenin 1, “Objekti i ligjit”?

Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Komisioni për Integritetin ka sjellë një shënim që lidhet me titullin, i cili ka të bëjë me direktivën e Këshillit Europian lidhur me shkëmbimin administrativ në fushën e tatimeve dhe shfuqizimin e direktivës nr. 77799, e cila ka ndryshuar dhe kërkon që ky lloj ndryshimi të reflektohet në titullin e ligjit që kemi.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Një minutë, të lutem! Do të mbajmë të njëjtin titull, por titulli ka një *footnote* që duhet të ndryshojë dhe për këtë arsye kërkohet të reflektojmë shënimin që ka sjellë Komisioni për Integritetin. Titulli mbetet i njëjtë, *footnote* do të ndryshojë se do të bëhet në përshtatje me direktivat e përditësuara të BE-së.

A jeni dakord me këtë ndryshim?

Dakord.

Për kreun dhe nenin e parë, që është objekti a ka shënime nga Komisioni i Ligjeve? A do t’i miratojmë me ndryshimet që ka sjellë Komisioni i Ligjeve, apo keni nevojë t’i lexojmë? Keni një kopje përpara.

Antoneta Dhima – Jo, ka disa ndryshime.

Milva Ekonomi – Domethënë, ne duhet të votojmë duke marrë parasysh që objekti i këtij ligji do të ndryshojë me ndryshimet që vijnë nga Komisioni i Ligjeve.

Antoneta Dhima – Nga ana e Komisionit të Ligjeve, te pjesa e parë hyrëse, riformulohet kështu: “Objekti i këtij ligji është përcaktimi i rregullave dhe procedurave në lidhje me...” dhe në të gjitha nenet e ligjit, ku është referenca ligjore VKM do të ndryshohet, sepse është riformuluar në nenin 4, shkronja “dh”. Njëkohësisht, përsëri te neni 1, shkronja “a” riformulohet: “Shkëmbimin automatik të informacionit, të llogarive financiare në zbatim të standardit të përbashkët të raportimit dhe marrëveshjes shumëpalëshe të autoritetit kompetent për shkëmbimin automatik të informacionit të llogarive financiare”.

Milva Ekonomi – Domethënë ligji nuk i referohet VKM-së, por legjislacionit shqiptar.

Antoneta Dhima – Nga Komisioni i Ligjeve për nenin 1 thuhet: “Detyrat dhe kompetencat zëvendësohen me të drejta dhe detyrime”. Këto janë ndryshimet që janë reflektuar nga Komisioni i Ligjeve.

Milva Ekonomi – A jeni dakord ta miratojmë nenin 1 me ndryshimet që vijnë nga Komisioni i Ligjeve?

Dakord.

Zoti Haxhi, kemi një vëmendje për ju. Nga komisioni bëhet pyetja. Ju keni qenë pjesë e diskutimeve në Komisionin e Ligjeve. A keni rënë dakord me këto ndryshime? A jeni në dijeni të ndryshimeve? Po për ndryshimet në nenin 1 që po miratojmë a jeni në dijeni?

Elton Haxhi – Për shkronjën “ç” mendojmë se ka një sugjerim nga Komisioni i Ligjeve, kurse për pjesën tjetër jemi në rregull? Neni 8 përcakton të drejtat dhe detyrimet.

Milva Ekonomi – “Detyrat dhe kompetencat”, ne kemi thënë “Të drejtat dhe detyrimet”.

(Diskutime pa mikrofon)

Është teknikë legjislative e pastër, nuk prek thelbin e ligjit.

Elton Haxhi – Duke qenë se te neni 8 i jemi referuar si “Detyrat dhe kompetencat” edhe tek....

Milva Ekonomi – Do ta ndryshojmë edhe atje, sepse për teknikë legjislative ndryshon vetëm gjuha dhe unë them që në këtë rast duhet të marrim në konsideratë Komisionin e Ligjeve. Kështu që kalon neni i parë sipas vendimit që mori komisioni.

Neni 2, “Qëllimi”.

A ka ndryshime nga Komisioni i Ligjeve?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Antoneta Dhima - ...tatimor dhe të evazionit fiskal, si dhe përmirësimin e pajtueshmërisë tatimore kombëtare e ndërkombëtare” dhe pas nenit 2 shtohet neni 2/1 me këtë përmbajtje: “Parimi i përgjithshëm. Shkëmbimi automatik i informacionit të llogarive financiare, bëhet duke zbatuar dispozitat e konfidencialitetit dhe të mbrojtjes së të dhënave personale në përputhje me legjislacionin kombëtar në fuqi”.

Milva Ekonomi – A jeni dakord me këtë propozim të Komisionit të Ligjeve?

Dakord.

Kalojmë te neni 3, që do të marrë numrin 4, por kur i referohemi miratimit do të bëhet numërimi dhe do t’i referohemi numërimit të vjetër. Për nenin 3 ka një shënim nga Komisioni i Ligjeve.

A e ka përpara Ministria ndryshimin e Komisionit të Ligjeve?

Antoneta Dhima – Te neni 3 është e njëjta gjë që thashë te neni 1, që bëhet ndryshimi, pra nuk do t’i referohemi VKM-së, sepse e kemi në pikën 4 të nenit 5 të këtij ligji.

Milva Ekonomi – Kjo kalon me miratim automatik, se vjen si procedurë.

A jeni dakord me nenin 3 “Subjektet”?

Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 4.

Antoneta Dhima – Nga Komisioni i Ligjeve në nenin 4 bëhen ndryshimet e mëposhtme në shkronjën “a”: të saktësohet marrëveshja me marrëveshjen shumëpalëshe në këtë fushë. Në shkronjën “b” të hiqet lidhëza “por”, në shkronjën “ç” të hiqet referenca VKM dhe të bëhet riformulimi si më poshtë: “Juridiksion i raportueshëm. Një juridiksion i identifikuar në listën e publikuar sipas përcaktimeve në aktet nënligjore të nxjerra në zbatim të këtij ligji” dhe pas shkronjës “g” të shtohet shkronja “gj” ku përkufizohet se çfarë është komentari.

Milva Ekonomi – A jeni dakord me këto ndryshime? A e keni plotësuar komentarin? Unë mendoj ta miratojmë me këto ndryshime dhe t’i caktojmë detyrën përfaqësuesve të ministrisë dhe Shërbimit Juridik të Kuvendit ta plotësojnë me të gjitha shënimet që janë vënë këtu.

Dakord?

Kalojmë te neni 5.

Gjithmonë me referencën e vjetër, sepse automatikisht do të marrë një numër të ri dhe ndryshimi që kemi bërë për VKM-në do të kalojë i korrigjuar. Nëse bëhet fjalë vetëm për atë ndryshim, Neta, unë mendoj se duhet ta kalojmë se është po e njëjta gjë.

Antoneta Dhima – Ka një ndryshim, pika 3 të riformulohet si më poshtë: “Informacioni duhet të dërgohet elektronikisht sipas një formati të standardizuar, duke përdorur teknologjinë e përshtatshme në përputhje me aktet nënligjore në zbatim të këtij ligji”.

Milva Ekonomi - A jeni dakord me miratimin e nenit 5?

Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 6. Vigjilenca e duhur.

Antoneta Dhima – Edhe këtu është e njëjta gjë.

Milva Ekonomi – Nëse është vetëm kjo kemi rënë dakord në parim që të përmirësohet gjithandej.

A jeni dakord me nenin 6?

Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 7. “Ndarja informacionit brenda të njëjtit grup, ose me ofruesit e shërbimeve, palë e tretë”.

A ka ndryshim nga Komisioni i Ligjeve?

Antoneta Dhima – Ka një ndryshim në pikën 3. Shprehja “mbetet” të zëvendësohet me “është”.

Milva Ekonomi – Pra “Institucioni financiar raportues është përgjegjës”.

Antoneta Dhima – Dhe të hiqet detyrimi për VKM-në me aktet ligjore në zbatim të ligjit.

Milva Ekonomi – A jeni dakord me ndryshimet e ardhura nga Komisioni i Ligjeve?

Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 8. “Detyrat dhe Kompetencat e autoritetit kompetent”.

Këtu kemi disa riformulime që kërkohen nga Komisioni i Ligjeve.

Antoneta Dhima – Pika 1 riformulohet si më poshtë:

“Autoriteti kompetent, nëpërmjet strukturave të tij të varësisë mund të kërkojë informacion nga çdo institucion financiar raportues në Republikën e Shqipërisë. Me lajmërim paraprak ai mund të hyjë në ambientet ku ushtrohet veprimtaria ekonomike e tij, me qëllim verifikimin e përmbushjes së detyrimit të përcaktuar në këtë ligj” dhe pika 2 riformulohet si më poshtë: “Brenda 7 ditëve pune, nga paraqitja e kërkesës me shkrim të autoritetit kompetent, institucioni financiar raportues i vë në dispozicion regjistrimet, apo të dhënat e mbajtura sipas nenit 9 të këtij ligji, si dhe çdo dokument tjetër, që i kërkohet për të kryer verifikimin e përmbushjes së detyrimit të përcaktuar në këtë ligj”. Të hiqet pika 3 dhe në pikën 4 fjalia “ky detyrim përfshin, por nuk kufizon vetëm në...” të zëvendësohet me informacionin shtesë “veç detyrimeve të tjera përmban...”.

Milva Ekonomi – Mbase sistemi automatik punon më shpejt.

Antoneta Dhima – Brenda minutës e merr informacionin.

Milva Ekonomi – Si mendojnë përfaqësuesit e ministrisë?

(Diskutime pa mikrofon)

Ju mendoni se duhet të rri 15 apo 7? Se ju jeni ata që keni zë në këtë.

Elton Haxhi – 15.

Milva Ekonomi – Ju mendoni se duhet të rri 15.

Elton Haxhi – Për përkufizimet e tjera jemi dakord.

Milva Ekonomi – Kolegë, a ta votojmë me 15 ditë, apo me 7? Me 7 ditë është propozimi që bën Komisioni i Ligjeve, kurse me 15 është kërkesa që bën ministria. Ne jemi përgjegjës, të dëgjojmë ministrinë. Unë jam me ministrinë. A ta votojmë me 15? Kush është dakord me 15?

Dakord për 15.

Po për ndryshimet e tjera, a jemi dakord me Komisionin e Ligjeve?

Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 9. “Mbrotja e të dhënave dhe detyrimi për ruajtjen e tyre”.

Antoneta Dhima – Ka vetëm një ndryshim të shkronja “a”, të plotësohet forma e mbajtjes së të dhënave nga letër në dokument letër.

Milva Ekonomi – Kush është dakord me këtë ndryshim?

Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 10 ka të bëjë me shkëmbimin e informacionit për llogaritë e raportueshme. Ka disa riformulime.

A do ta lexosh Neta riformulimin që ka ardhur nga Komisioni i Ligjeve? Ministria e ka parë, mbase nuk ka nevojë ta rilexojmë.

Elton Haxhi – Jo, nuk jemi dakord me riformulimin pasi duhet ti bëhet një referencë konventes. për më tepër që kërkuam për ta bërë ndryshimin.

Milva Ekonomi – Të korrikut?

Elton Haxhi – Jo, është te neni tjetër, këtu mbetet 9-mujori, por riformulimin nuk e gjejmë me vend. Pra është hequr referenca e konventës dhe është bërë e përgjithshme “standardet kombëtare të ratifikuara”, pa iu referuar neneve specifike të konventës.

Milva Ekonomi – Këshilltarët tanë juridikë na thonë që nuk ka arsye t’i referohen konventës, sepse kështu është teknika legjislative në vend. Unë mendoj se, në këtë rast, Komisioni i Ligjeve është komisioni më kompetent për këtë çështje dhe këtu është vetëm një rregullim i teknikës legjislative. Pavarësisht nga qëndrimi i Ministrisë së Financave, ju ftoj të votojmë variantin e Komisionit të Ligjeve, atë të ndryshuarin.

A jeni dakord me variantin e Komisionit të Ligjeve?

Dakord.

Kalojmë te neni 11. “Kundërvajtjet administrative”.

Kemi disa ndryshime.

Neta, a do të vazhdosh me ndryshimet?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Vetëm sa është përmirësuar gjuha legjislative.

Antoneta Dhima – Pas shkronjës “c” shtohet shkronja “c/1” me këtë përmbajtje: “Kryerja e deklaramit të rremë nga çdo mbajtës i llogarive të raportueshme, ose person tjetër përgjegjës, në kundërshtim me kërkesat e këtij ligji dhe akteve nënligjore në zbatim të tij, dënohet me 1 milionë e 500 mijë lekë gjobë” dhe shkronja “ç” të riformulohet si më poshtë: “Pengimi nga personat përgjegjës në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë, me qëllim mosushttrimin e të drejtave dhe detyrimeve të autoritetit kompetent, të përcaktuara në këtë ligj dhe në aktet nënligjore në zbatim të tij dënohet me 1 milionë lekë gjobë” dhe shkronja “d” të riformulohet si më poshtë: “Zbatimi në mënyrë të gabuar i rregullave të vendosura mbi vigjilencën e duhur, si pasojë e neglizhencës nga personi që ka për detyrë t’i zbatojë ato dënohet

me 100 mijë lekë gjobë” dhe pas shkronjës “d” shtohet shkronja “d/1” me këtë përmbajtje: “Kryerja me dashje e veprimit në kundërshtim me rregullat e vendosura mbi vigjilencën e duhur nga subjektet përgjegjëse, dënohet me 250 mijë lekë gjobë”.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Janë ndarë, pra ka një kategorizim, janë shtuar 2.

Milva Ekonomi – Masat janë aty, janë rishkallëzuar, të dyja masat kanë pasur një vlerë, masat si masa kanë qenë atje, kurse vlera monetare e masës ka ndryshuar, pra është bërë riformulim i kategorizimit në vlerë.

Antoneta Dhima – 1 milionë dhe 1 milionë e 500 mijë. Mosdhënia e informacionit të kërkuar nga çdo mbajtës i llogarive raportuese është 1 milionë, ndërsa deklarimi i rremë gjobitet me 1 milionë e 500 mijë, zbatimi i rregullave gjobitet me 100 mijë, kurse kryerja me dashje gjobitet me 250 mijë.

(Diskutime pa mikrofon)

Milva Ekonomi – A jeni dakord me këto ndryshime që ka sjellë Komisioni i Ligjeve?

Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Kalojmë te neni 12.

Antoneta Dhima – Vetëm ndryshimi i VKM-së.

Milva Ekonomi – Edhe te neni 12 besoj se biem dakord për ankimimin.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Edlira Hyseni – Kjo masa e gjobës 10 mijë lekë për mosdhënien e informacionit, që është për institucionet financiare apo për autoritetin kompetent, që janë tatimet, është 10 mijë lekë në vit? Ai mund ta dorëzojë pas një viti.

Milva Ekonomi – Nuk ka të bëjë me vitin, kjo është sa herë të kërkoj unë.

Edlira Hyseni – Shkëmbimi i raporteve është një herë në vit i detyrueshëm. Në muajin maj për bankat dhe në muajin shtator për tatimet. Unë mendoj se për 10 mijë lekë nuk ia vlen që bankat dhe tatimet ta japin informacionin në kohë, madje mund ta vonojnë sa të duan. Do të ishte më mirë 10 mijë për çdo muaj vonesë, që mund t'i dhëmbë pak më shumë, apo 10 mijë lekë dhe kaq? Po të isha unë bankë apo tatime nuk do ta jepja informacionin për një vit të tërë për një masë kaq të vogël, sepse është shumë disproporcional 10-mijëlekëshi me 1 milionë të rinj që ne më pas vendosim masat e tjera. Nuk po flasim për individë se, po të prekeshin individë të

thjeshtë, 10 mijë lekë nuk janë pak, por nëse subjektet që penalizohen, janë bankat dhe tatimet 10 mijë lekë janë shumë pak për të mos e dhënë në kohë.

Milva Ekonomi – Po më pas, kur ai nuk e dorëzon fare?

Antoneta Dhima – Te shkronja “ç” thuhet: “Pengimi nga personat përgjegjës, në mënyrë të drejtpërdrejtë...”

Edlira Hyseni – Ky nuk është pengim, por është mosdeklarim në afat dhe ky është vendimi i asamblesë, si vendimet e tjera.

Milva Ekonomi – Ai për vonesën paguan 100 mijë lekë, kurse ai tjetri për mosdhënien në kohë paguan 1 milion. Domethënë, në këtë rast ai do të paguajë 1 milion e 100 mijë lekë, se këtu është e përcaktuar masa e gjobës. Unë kështu e kuptoj.

Antoneta Dhima – Zonja Kryetare, në lidhje me pretendimin e koleges, ju sqaroj se te shkronja “ç” është e përcaktuar se pengimi nga personat përgjegjës dënohet me gjobë 1 milion lekë, kështu që ai duhet të paguajë edhe 10-mijëlekëshin, por duhet të paguajë edhe 10 milionë për arsye të mosdhënies së informacionit.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Përderisa unë them se ti duhet të raportosh në datën 20 dhe ti nuk raporton, detyrimisht që do ta paguash edhe 10-mijëlekëshin, por edhe 1 milionëshin.

(Diskutime pa mikrofon)

Milva Ekonomi - Unë mendoj se këtu ka një sens logjik, siç e shpjegoi edhe zonja Antoneta, mosdorëzimi në afat është një masë që ne e kemi aktualisht tek tatimet sot. Pra, është një procedurë që nuk është e pashkelur nga bizneset, të cilat përpiqen të deklarojnë në afat TVSH-në, ndaj për mosdorëzimin në afat marrin penalitete.

(Diskutime pa mikrofon)

Ju keni të drejtë dhe ne po e sqarojmë. Tani po ia kaloj fjalën edhe përfaqësuesit të Ministrisë së Financave, në mënyrë që të na e shpjegojë edhe një herë këtë gjë dhe më pas ta hedhim në votim.

Elton Haxhi – Pra, 10 mijë lekë aplikohen për vonesë, por, nëse nuk e sjell fare aplikohet gjoba për mosdhënie. Pra, nëse ti e ke afatin për ta paguar në muajin maj dhe nuk e sjell në këtë muaj, por e sjell në muajin qershor, atëherë aplikohet penalteti për vonesën. Nëse ti nuk e sjell fare, unë duhet të raportoj në shtator për autoritetin tjetër tatimor dhe nëse nuk e kam raportin

nga një institucion financiar, atëherë do të aplikohet penalteti. Tani këto do të detajohen edhe në aktet nënligjore, por besoj se është e qartë.

Milva Ekonomi- Atëherë, a jeni dakord me ndryshimin që ka sjellë Komisioni i Ligjeve për këtë nen për “Kundërvajtjet administrative? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Kalojmë te neni 12 “Ankimi”. Komisioni i Ligjeve i bën referencë vetëm asaj që kemi rënë dakord në fillim.

Kush është dakord me ndryshimet që ka sjellë Komisioni i Ligjeve? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 13 “Rregulli kundër shmangies”.

Kush është dakord me nenin 13? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Kalojmë te kreu IV “Konfidencialiteti dhe sigurimi i të dhënave”.

Neni 14 “Konfidencialiteti”. Komisioni i Ligjeve edhe këtu ka sjellë një riformulim.

Po, zonja Antoneta.

Antoneta Dhima - Pika 1 riformulohet si më poshtë: “1. Informacioni i siguruar nga institucionet financiare raportuese në Republikën e Shqipërisë është konfidencial.”

Pika 4 riformulohet si më poshtë: “4. Informacioni i marrë nga autoritetet kompetente të huaja duhet të mbahet konfidencial, në përputhje me standardet ndërkombëtare të ratifikuara nga vendi ynë dhe legjislacioni vendas.” Këto janë ndryshimet.

Milva Ekonomi – E hedhim në votë nenin 14.

Kush është dakord me nenin 14 të riformuluar nga Komisioni i Ligjeve? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 15 “Siguria e të dhënave”. Këtu nuk ka asnjë ndryshim.

A jeni dakord me propozimin e ardhur nga Ministria e Financave për nenin 15? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Kalojmë te kreu V “Dispozita përfundimtare”.

Neni 16 “Interpretimi”. Edhe këtu është e njëjta gjë dhe kemi rënë dakord.

A jeni dakord me propozimin e ardhur nga Komisioni i Ligjeve për nenin 16? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 17 “Aktet nënligjore”. A është në rregull afati 3 muaj, sepse ju vetë e keni propozuar. Dakord!

A jeni dakord me nenin 17?

Antoneta Dhima - Këtu thuhet: “Neni 17 të riformulohet duke përcaktuar dispozitat e ligjit në zbatim të të cilave do të nxirren aktet nënligjore”. Unë nuk e kuptoj këtë gjë.

(Diskutime pa mikrofon)

Milva Ekonomi – Atëherë, këtë referim që do të ketë neni 17, sipas propozimit për ndryshim që ka bërë Komisioni i Ligjeve, ne do t’ia lemë komisionit dhe sekretarisë sonë juridike që t’i përfundojë këto referenca për ta pasur gati për zbardhje.

A jeni dakord me ndryshimet në nenin 17? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 18 “Dispozita kalimtare”.

Antoneta Dhima – Këtu faktikisht nga Ministria ka një propozim që të shtyhet afati 30 maj 2020, në kushtet kur mendohet që ne si komision duhet ta kishim shqyrtuar menjëherë pas Komisionit të Ligjeve dhe normalisht i bie 31 korrik.

Milva Ekonomi - Ne si komision jemi dakord me propozimin që bën Ministra e Financave. A jeni dakord me këtë pjesë? Dakord!

Antoneta Dhima – Gjithashtu, duhet të korrigjohet numërimi.

Milva Ekonomi - Patjetër! Ne e kemi zbardhur korrigjimin e neneve.

Kalojmë te neni 19 “Hyrja në fuqi”.

Elton Haxhi – A mund të them diçka.

Milva Ekonomi – Patjetër!

Elton Haxhi – Unë do të kërkoja edhe një herë rishikimin e propozimit të Komisionit të Ligjeve për nenin 2 “Qëllimi” dhe nenin 10.

Milva Ekonomi – Çfarë keni lidhur me nenin 2?

Elton Haxhi – Neni 2 e zgjeroi fushën dhe futi të gjithë shmangien e detyrimeve tatimore si objekt të këtij ligji. Pra, e ka zgjedhur fushën përtej qëllimit të këtij ligji. Pra, kemi vërejtje për zgjerimin e efekteve, pasi nuk është i tillë.

Te neni 10 është thjeshtëzuar apo është përgjithësuar duke hequr referencë ndaj konventës, gjë që ne gjykojmë se duhet të jetë...

Milva Ekonomi – Nuk e gjykoni dot ju, se ajo ashtu është bërë për të gjitha ligjet.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Elton Haxhi – Nuk është pra, sepse standardi i përbashkët...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Nuk është i ratifikuar standardi. Pra, standardi i përbashkët i raportimit nuk është i ratifikuar me asnjë akt ligjor, prandaj duhet të jetë këtu. Për më tepër që këto janë parë me shumë kujdes bashkë me ekspertizën e huaj dhe gjykojmë se çdo ndryshim në këta terma dhe në këto referenca, që ne kemi vënë, mund të na ndikojnë në vlerësimet që do të na bëjë në të ardhmen OECD-ja në lidhje me aplikimin e këtij ligji. Kështu që për këto dy nene, për nenin 2 dhe për nenin 10, do të kërkoja...

Milva Ekonomi – Neni 2 është e bazuar te një konventë e ratifikuar dhe ka një numër ligji, prandaj ato nuk e vënë atje.

Nëse do të shikoni atë që ju keni sjellë, do të vini re se është një konventë e ratifikuar dhe, ndërkohë, e paskeni një ligj për këtë konventë. Nga ana tjetër, te pjesa “Kompetent për shkëmbimin e informacionit të llogarive financiare për shmangien e mashtrimit tatimor dhe evazionit fiskal”, nuk është fusha e zbatimit dhe ato e kanë kështu siç është, nuk ke vendosur fushë zbatimi këtu.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Nuk ka ndryshuar asgjë dhe, nëse do ta lexoni, ka mbetur i njëjti tekst dhe është ndarë me pika 2 dhe 3 për qëllime më të mira përdorimi.

Elton Haxhi – A mund ta rishikojmë edhe njëherë tekstin me shërbimet?

Milva Ekonomi – Atëherë, unë po ju lexoj tekstin origjinal atë që ju keni depozituar dhe më pas krahasojeni me atë që do të lexojë zonja Antoneta nga Komisioni i Ligjeve.

Neni 2: “Ky ligj synon sigurimin e zbatimit të dispozitave të Konventës për Ndihmën e Ndërsjellë Administrative në Çështje Tatimore, ratifikuar me ligjin nr. 146/2013 “Për ratifikimin e konventës për ndihmën administrative të ndërsjellë në çështjet tatimore”, të marrëveshjes shumëpalëshe të autoritetit kompetent për shkëmbimin automatik të informacionit të llogarive financiare...”. Këtu mbaron referenca, e cila është e miratuar me ligj dhe më pas fillon përmbajtja: “...për shmangien e mashtrimit tatimor dhe të evazionit fiskal, si dhe për

përmirësimin e pajtueshmërisë tatimore kombëtare e ndërkombëtare, duke zbatuar dispozitat e konfidencialitetit dhe të mbrojtjes së të dhënave personale në përputhje me legjislacionin kombëtar në fuqi”. Ky është varianti i Ministrisë së Financave.

Ndërkohë që varianti që ka sjellë Komisioni i Ligjeve është si më poshtë: “Ky ligj synon zbatimin e standardeve ndërkombëtare për shmangien e mashtrimit tatimor dhe të evazionit fiskal, si dhe përmirësimin e pajtueshmërisë tatimore kombëtare e ndërkombëtare.” Më pas shton një pikë tjetër të nenit që është neni 2/1 “Parim i përgjithshëm”, ku thuhet: “Shkëmbimi automatik i informacionit të llogarive financiare bëhet duke zbatuar dispozitat e konfidencialitetit dhe të mbrojtjes së të dhënave personale, në përputhje me legjislacionin kombëtar në fuqi.” Pra, nuk ka hequr asgjë nga ajo që keni paraqitur ju.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po, është referenca dhe ne kemi miratuar një ligj për këtë.

(Diskutime pa mikrofon)

Unë mendoj se formulimi juridik është rregulluar dhe është bërë më i përshtatshëm.

Elton Haxhi – Këtu thuhet: “...u referohet standardeve ndërkombëtare të raportimit për shmangien...” ndërkohë që ne u referohemi standardeve ndërkombëtare për shkëmbimin e informacionit. Pra, për shkëmbimin dhe jo për shmangien.

(Diskutime pa mikrofon)

Unë them që ta miratojmë nenin 2 me të dyja ndarjet, pra neni 2 dhe neni 2/1. Ndërkohë, për rregullim e fjalëve “shmangie” dhe “shkëmbim”, ju lutem, rregullojeni së bashku me shërbimin tonë juridik, sepse kam përtypjen se duhet të jetë një lapsus dhe asgjë më shumë. Unë mendoj se duhet ta miratojmë kështu siç e kemi dhe të lejojmë të dyja palët ta riformulojnë më mirë nenin 2.

Elton Haxhi – Te neni 10, nëse mund të shtojmë standardin e përbashkët të raportimit, mund ta rregullojmë përsëri me versionin e propozuar nga Komisioni i Ligjeve. Pra, le të mbajmë versionin e ardhur nga Komisioni i Ligjeve.

Milva Ekonomi – Edhe këtu i drejtohet një ligji të miratuar, prandaj është hequr.

Elton Haxhi – Duhet të përmendim edhe standardin.

Milva Ekonomi – E kuptuam këtë gjë dhe kjo duhet të rregullohet nga shërbimi ynë këtu.

A jeni dakord ta kalojmë në tërësi projektligjin? Në rregull!

Kush është dakord në tërësi me projektligjin? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka?
Miratohet.

Faleminderit!

Besoj se ju kemi dhënë mundësi për një bashkëveprim më të mirë me të gjitha institucionet ndërkombëtare, si dhe me ato që janë të rëndësishme në raportimin e ekonomisë informale.

Punë të mbarë dhe na informoni edhe ne për ecurinë lidhur me projektligjet!

MBYLLET MBLEDHJA

Sekretar
Anastas Angjeli

Përgjegjësjë e Sektorit të Redaktorëve
Euzheni Pengili

Sekretar i komisionit
Elvi Prifti